



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 5269/12 Prot

Gramsh më 29.12.2022

VENDIM

Nr. 105, datë 27/12/2022

**PER**

**“DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 96 DATE 30.12.2019 “PER MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE ,ADMINISTRIMIN E TYRE SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 gërma f", Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të përbashkët nr.655/1 datë 06.02.2007 të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme "Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore", Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës .....12.2022, pasi mori në shqyrtim projektin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për disa ndryshime në vendimin nr.96 datë 30.12.2019 "Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore, administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative


**VENDOSI**

Të miratojë disa ndryshime në vendimin nr.96 datë 30.12.2019 "Për miratimin e nivelit të taksave e tarifave vendore, administrimin e tyre si dhe penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative si më poshtë:

1. Pika 7/3, Ndryshim projekti gjatë ndërtimit, për objekte mbi tre kate bëhet 20 000 lekë.
2. Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh bëhet 10 000 lekë.
3. Në pikën 8 "Pranim Kërkesash" shtohet tarifa për punime për ndryshimin e funksionit dhe bëhet 10 000 lekë.
4. Në pikën 9 "Taksë e përkohshme për Infrstrukturën Arsimore" zëvendësohet me "Taksë e Ndikimit në Mjedis".
5. Në pikën B "Nxjerrja ose grumbullimi në sipërfaqen e fondit pyjor e kullësor", Vërtetime transporti material drusor etj.. bëhet 200 lekë/numër serie.
6. Përrjashtohen nga taksat dhe tarifavat vendore subjektet që hapen gjatë vitit 2023 dhe që kanë mbi tre të punësuar.

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoritë, Sektorët pranë Bashkisë dhe Njësitë Administrative.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK  
Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT  
Greta LENA



Konc. Xh.Gjini  
Miratoi. G.Lena  
Konf. G.Lena

